

Qershor-Korrik-Gusht2016 Botim i Qendrës, Agjencia AJMMI (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit) Nr. 15



Ishulluj e demtuar te Ksamilit (FOTO: SH.H-AJMMI)



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NE SHQIPERI



Botim i numrit te kesaj Reviste realizohet ne kuader te projektit te AJMMI-t: "Sensibilizim mjedisor dhe rehabilitim i gjelber i Ishujve te Ksamilit" - ACHIEVE; aktivitetet i mbeshetetet nga REC Shqiperi dhe financuar nga BE ne kuader te projektit "Shoqeria civile shqiptare per nje mjedis evropian"

## “Urat e Mjedisit”

është botim periodik i Qendrës “AJMMI” (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit). Në këtë revistë do të gjeni informacione dhe opinione mbi problematikat mjedisore kryesisht në jug të Shqipërisë si dhe çështje të lidhura me zhvillimin e mediave dhe trajnimin e gazetarëve në një rajon multikrahinor e multietnik.

është organizatë joqeveritare, AJMMI jofitimprurëse e jopolitike, e përbërë nga specialistë me përvojë të mjedisit dhe medias që operon në fushat respektive të mjedisit dhe medias, përgjithësisht në rajonin Jonian, në jugun e Shqipërisë e me gjerë. Agjencia “AJMMI” është krijuar në vitin 2007.

**VISIONI i Agjencisë “AJMMI: “Miqësor ndaj Mjedisit dhe një Media me fytyrë publike”**

### STAFI BOTUES

EDITOR: Shkëlqim HAJNO

### REDAKSIA:

Kryeredaktor: Dr Agim NELAJ  
Panajot BOLI, Blerim KORE  
Aferdita SELIMAJ, Sofokli MEKSHI,  
Xhorxhi VASILII

### KONSULENTË:

Për mediat:  
Fatos BAXHAKU - Publiçist  
Për mjedisin:  
Ing. Kristo KAURI

### ADRESA:

Agjencia “AJMMI”/Rr.”A.Çuni”,  
Nr.35.L.Nr.4, Sarandë/  
Tel/fax: 0852 25678 / 06922 35 026/  
0692708020 / 0683031436  
agency\_ajmmi@yahoo.com  
/ www.ajmmi.com

### NR. I LLOGARISE

SOCIETE GENERALE ALBANIA  
0001177415

### IBAN:

AL 9221363010000000001177415

### Qendra AJMMI OJF

Shtypur në shtypshkronjën “Argiro”,  
Gjirokastër / Art Desing: **Alda Muho**

## NGA BRENDIA

### INTERVISTA\_ “Rikthim ne ishuj....”

**N**derhyrja, është një projekt pilot me plan veprimi te qartë, konkret me objektiva sensibilizimi dhe ndërgjegjesimi. Eshte një model i mirë për planifikimin e masave komplekse për rehabilitimin, analizën llogjike te gjëndjes dhe rikthimin e vlerave të mëparshme...”

Ing. Kristo KAURI

4



### REPORTAZH: “Turizëm: Nga Madridi në Kurvelesh” -Aty ku Spanja mund Nivicën 6-1-

**P**as mbërritjes në Nivicë dhe pritjes mjaft të ngrohtë dhe miqësore, ajo që do të surprizonte, ishte ardhja e ambasadores së Mbretërisë së Spanjës znj. Silvia Josefin Kortez Martin, së bashku me fëmijët e saj të veshur me bluzat kuq e zi, të cilët padyshim i kishte sjellë për të njour me këto mrekulli të zones”

Nga Aleksander TOTI

3




### OPINION: Informimi, ura e lëkundur me tri harqe...

**P**ër t'u përcjellë te publiku, lajmit/informacionit, zakonisht i duhet të kalojë në një urë me tri harqe: burimi (zyrtar)-gazetari - media. Shpesh kjo “urë” lëkundet...

Nga Shkëlqim HAJNO

7



### FOKUS: Informacioni nga institucionet rrit besueshmerine, transparencen, kulturen e komunikimit.

**C**do qytetar ka nevojë per nje informim te sakte e korrekt. Kjo rrit besueshmerine, transparencen, shmang konfliktet, parandalon panikun, permireson kulturen demokratike te komunikimit.

Nga Panajot BOLI

6



### OPTIKE: GJIROKASTER, Integrimi i personave me aftësi të kufizuar

**B**ashkia e Gjirokastës,, duke e konsideruar këtë kategori pjesë te domosdoshme e shoqërisë ka treguar kohët e fundit vëmëndjen maksimale për të siguruar akses dhe lehtësi në të gjitha institucionet e qarkut dhe hapësirat publicEe

Nga Mimoza LLAVDANITI

10



### GJIROKASTËR: Arjan Shehu, 50 vite me isopolifoninë labe në buzë

**Z**ëri i tij si marrësi i isopolifonike do ta shndërronte mërmërimën e polifonisë labe në një ujëvarë ndjenjash dhe emocionesh..

Nga Blerim KORE

11



### KUJTIME: Udhëve te femijerise me grekun Andonis Peskos.

**T**e tre vëllezërit dhe motra e tyre vijne gati cdo dy vjet ne fshat. Por hera pare qe u takova me Andonin, ndodhi ne vitin 2000. Ai jeton e punon ne Australi qysh nga vitet 70, por e ka fiksime te vije ne Nivicë...”

Nga Sofokli MEKSHI

12-13



### MUZA: “Një histori didaktike e pabesueshme.”

**U**dhëtuan deri në Palo Alto në Kaliforni ku themeluan Universitetin që mban emrin Stanford University, ne kujtim të djalit të tyre të cilin Harvardi e kishte harruar. Kurrë nuk duhet të gjykojmë të tjerët nga rrobat që kane veshur....

Përktheu: Vasilika IFANDI

15



## Turizëm: Nga Madridi në Kurvelesh Aty ku Spanja mund Nivicën 6 -1



**Nga Aleksander TOTI**

Tepelena nuk kishte parë që shumë të huaj sa këto ditë. Qendra e re e qytetit, pjesë e “Rilindjes urbane”, jo vetëm që e ka gjallëruar qytetin e Aliut prej vetë qytetarëve të saj, të cilët ndihen të “rilindur” nga një cilësi tjetër jete, por dhe nga qindra studentë spanjollë, të ardhur për një tur 3-ditor këtyrë anëve, më saktë zonës së Kurveleshit, një pasuri e jashtëzakonshme natyrore e jo vetëm. Ne kete njohje te te krahines me vlera , ende e pazbuluar, per turistet ndikoi njeriu i apasionuar, djalë Kurveleshi, Auron Tare. Me një përjetim mjaft emocionues, si asnjëherë më pare, i gjithë qyteti ka pritur me kureshtje dhe buzëqeshje të ngrohtë të rinjtë e ardhur nga Madridi, të cilët zgjodhën të vizitonin Tepelenën e pikërisht zonën më atraktive për turizmin e aventurës, Kurveleshin, në këto ditë të nxehta verore. Duke mbërritur kështu

rreth orës tetë të mbrëmjes, të ndalur vetëm për pak çaste, nën shoqërimin e kryetarit si dhe përfaqësuesve të tjerë të bashkisë, pa humbur asnjë moment nga koha e tyre, kanë zgjedhur të marrshojnë në këmbë për të shijuar rrugën drejt Kurveleshit. Një sfidë mjaft e bukur dhe paharrueshme do të ishte për ta kjo ngjitje e rrugës që gjarpëron shpateve të maleve të natyrës së egër, nën shoqërinë e gurgullimës së burimeve të pafundme të këtyrë grykave, apo simfonisë muzikore të gjallesave që pushtojnë gjithë atë pyll alpesh në mbrëmje. Do të zgjaste për rreth tre orë ky udhëtim deri në arrijtjen e destinacionit të parë e cila ishte pikërisht në fshatin më të afërt të zonës, Lekdush, ku një grup i organizuar banorësh dhe punonjësish do të bënin pritjen duke ofruar ndihmën e nevojshme për të siguruar një fjetje të sigurt në çadrat e tyre.

Të gjendur mes malesh në lartësinë 1500 metra rreth zjarrit ndezur e aspak të lodhur pas asaj rruge për afro 17 km, të gjithë së bashku, nën drejtimin e At Hoses, apo El Padre-s siç e quanin ata, kremtojnë ritin e faljes sikurse e do besimi katolik të cilin praktikojnë.

“Është e jashtëzakonshme ndjesia që të jep kjo natyrë e ky vend, ka një aromë freskie dhe paqeje si askund. Nuk kemi parë kurrë kaq shumë yje në qiell, ka aq shumë sa duket se preken me ato majat e larta të atyre maleve aty përballë. Gjen një paqe shpirtërore që duket se vjen nga universi i cili është kaq i afërt këtu. Nuk e di, por është e papërshkrueshme, çdokush duhet të vijë e ta ndjejë këtë këtu”, shprehen dy nga studentet duke vazhduar mbrëmjen mes tyre dhe muzikës së kitarës që qëndroi thuasje deri afër mëngjesit. /Duke rënë mëngjesi tjetër, filloi zgjimi si dhe përgatitja për të vijuar turin ndërkohë që po bëhej gati ushqimi me prodhimet e zonës si mjaltë, qumësht apo gjalp të cilat padyshim që i shijuan në maksimum sikurse u shprehën.

Ajo çka preceptohej nga sytë e të rinjve aty përpara nisjes, ishte pamja piktoreske e Stomiries „ një mur gjigand shkëmbor buzë kanionit të thellë me ujvara të larta.

Startoi kështu ecja në këmbë nga fshati i parë i Kurveleshit të Sipërm, për të vijuar më pas me një ndalesë pushimi nën hijen e rrepeve shekullorë në qendër të Progonatit, ku dallohej Shpati i Malit të Thatë apo malet murale të Këndrevicës.

Vazhdoi kështu udhëtimi në këmbë shoqëruar nga kështjella e këtyrë maleve me pamjen mahnitëse të të gjithë këtij biodiversiteti natyror e cila krijon edhe një mikroklimë midis Buzës së Bredhit , Ujvarave të Thella e të Larta apo Pyllit të Lajthizës i cili shtrihej në faqen e malit ku degëzohej rruga për në Kuç të Vlorës.





**Me ing. Kristo Kaurin**

-Agjencia AJMMI është përfshirë gjatë këtij vitit deri në qershor të vitit 2017 në projektin “Ndërgjegjësimit mjedisor dhe rehabilitim i gjelbër i Ishujve të dëmtuar të Ksamilit , duke adresuar parandalimin e metejshtëm”-projektit I mbështetur nga REC Shqipëri në kaudër të programit të BE-s, ARCHIVE-Mbështetje për Shoqërinë Civile Mjedisore ne Shqipëri. Drejtues i projektit është Shkëlqim Hajno , njehërësh edhe drejtor i ekzekutiv i AJMMI-t ndërsa drejtues teknik, ing.Krtisto Kauri. Në vijim, intervista e z.Kauri mbi hapat për ndërhyrjen rehabilituese në ishujt e Ksamilit.

**1) AJMMI e vlereson projektin si një rikthim në ishujt e Ksmilit. Me një mbështetje modeste nga REC ne v.2014, AJMMI bëri ndërhyrjen e parë .Ku rezultoi ajo ndërhyrje operationale dhe përse lindi nevoja për një rikthim?.**

Përgjigje:- Para se t’iu pergjigjem pyetjeve tuaja, dua te informoj lexuesit e revistës “URAT e Mjedisit” se organizata AJMMI qe fitoi grantin e ketij projekti nga REC dhe BE, jo rastesisht dhe as aksidentalisht. Kjo është rrjedhojë e përpjekjeve me pergjegjësi, e ndjeshmerisesesajndajproblemeve te mjedisit.AJMMI nga viti ne vit, ka ardhur ne rritje duke formuar një profil të plotë dhe kompetent për zgjidhje dhe zgjedhje të mençura në rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara në natyrë. Projekti dhe realizimi i tij është një gur prove për AJMMI-n , per rritjen e profilit te saj për të ardhmen, duke marrë përsipër projekte edhe më ts veshitira me impakt pozitiv në mjedis.

## Rikthim në ishujt e dëmtuar.....

Eshte nje rikthim ne ishujt e Ksamilit, pas nje investimi modest qe REC – u beri ne vitin 2014. Punët nuk duhen lënë përgjysëm. Degradimi, dëmtimi i habitateve sjell degradimin dhe varferimin e komuniteteve. Faza e parë ishte në stabilizimin e skarpatës së erduar, pastrimin e mbeturinave dhe mbjelljen e nje sasive dafine. Rikthimi, nuk është detyre e thjeshtë. Zbatimi I ketij projekti kerkon partneritet, performancë dhe pergjegjësi për zgjidhjen përfundimtare te problemeve mjedisore më ishujt e dëmtuar ne Ksamil që ky fenomen(dëmtimi nga dora e njeriut) të mos përsëritet. Realizimi i projekti do te nxise rolin e bashkise, stafet e saj, NJA Ksamil, AZM, Parkun Kombëtar te Butrintit, nxënësit e shkollës së qytezës si edhe gjithë komunitetin e banoreve përreth saj ,qe te jene aktiv në mbrojtje të natyres dhe të mjedisit ndaj cdo veprimi të paligjshem. Bukuria natyrore, ishujt, flora dhe fauna, i japin jetë zonës së banorëve në Ksamil. Prandaj, ruajtja me mençuri dhe përgjegjësi është në interesin tonë. Ky projekt, gjithashtu fton për rishikimin e zhillimit te zonës në mënyrë të qëndrueshme, rishikim të burimeve natyrore dhe vendosjen e raporteve miqësore midis njeriut dhe natyrës.

**2) Cfarë parashikon në fazat e tij zbatuese projektit në aspektin a) të sensibilizimit dhe b) në ndërhyrjet operationale në terren?**

Pergjigje. Nderhyrja, është një projekt pilot me plan veprimi te qartë, konkret me objektiva sensibilizimi dhe ndërgjegjesimi. Eshte një model i mirë për planifikimin e masave komplekse për rehabilitimin, analizën llogjike te gjëndjes dhe rikthimin e vlerave të mëparshme. Ky projekt parashikon ricungimin e sipërfaqes së djegur, pastrimin e sipërfaqeve te ndotura, hapjen e gropave dhe mbjelljen në to, të me shumë se 1600 fidanave autoktonë, ujitjen e tyre deri në zënie dhe bërjen e gardheve të “gjalla”. Veprimet operationale do te shoqerohen edhe me mesazhe sensibilizuese, ndërgjegjesimi, cka përben, një nga objektivat kryesore të projektit. Te gjithë se bashku: nxënësit dhe komuniteti , specialistë e punonjës publikë, mundemi ta mbrojmë mjedisin dhe natyrën dhe mund të kurojme cdo plage të saj.. Tryezë mjedisore me specialistë, ekspertë dhe përfaqësues të komunitetit; sensibilizim

i mbi 200 nxëtës dhe jo vetëm, 70 vullnetarë mjedisore, një film dokumentar, ekspozitë fotografike, frekuentim i Ishujve gjatë ndërhyrjeve operationale nga me shume se 2000 vizitorë, vendosja e tabelave ,patronazhi, stampimi I gati 200 bluzave me sloganin:” Une, i dua Ishujt e Ksamilit”;etj., do te plotesojne imazhin e ketij aktiviteti, duke dhene njëherazi edhe një mesazhe domethënëse miqësore për mjedisin.

**-3) AJMMI nënshkroi pak kohë më parë në klimën e zbatimit t projektit të mbështetur nga REC dhe BE , Memorandumin e Bashkëpunimit me disa aktorë pjesëmarrës me impakt në qëndrimin ndaj ishujve? Cilët janë këta aktorë dhe roli i tyre?**



Pergjigje. Memorandum I bashkepunimi sikurse e përmendët përfshin disa aktorë të rëndësishëm si : Parkut Butrint, shkolla dhe ZArsimore e rrethit, NJA (Njësia Administrative Ksamil) si pjesë e bashkisë Sarandë, nënprefektura e Sarandës, etj., aktoreve dhe faktoreve me ndikin ne territor dhe ne komunitet. Ky project mban prasysh planin e menaxhimit te Parkut Kombëtar të Butrintit, pasuri e UNESKO-s dhe statusin nderkombëtar të tij. Vizitat studimore në ishuj, para dhe pas rehailitimit, janë nisma qe ofrojne komunitetin prane natyres dhe promovojnë ne nje kendveshtrim vlerat dhe habitatet që ofrohen. Bashkëpunimi, bashkveprimi, monitorimi, autoriteti dhe pergjegjeshmia e aktorëve, garanton qëndrueshmrinë e projektit. Ky aktivitet nuk I takon vetem AJMMIT,

vijon në fq 5

por synon nje qasje tjeter, nje model per nje kulturë mjedisore, një bashkim zërash e veprimesh të shoq.civile.komunitetit dhe institucioneve shtetërore.

**-4) Cilat do të ishin impaktet negative në të ardhmen e afërt në dy ishujt e dëmtuar të Ksamilit, nëse, nuk do të ndërhyhet nga projekti I AJMMI-t?**

Pergjigje Rehabilitimi nga vete natyra, do të kërkonte një kohë mjaft të gjatë, nga 60 ne 100 vjet. Skarpatet e erruduara-



dhe te dëmtuara nga tritoli, pa këtë ndërhyrje janë të destinuara të vazhdojnë të shkaterrohen me tej. Madje, me ritme edhe më të shpejta. Kështu ,cdo vit, bien në det nga errodimet mbi 600 m3 dhera dhe bimësia e makjes mesdhetare është dëmtuar seriozisht. Nderkohe që sipërfaqia e djegur dhe e dëmtuar dhe e zhveshur ne ishullin tjeter; prish njekohesisht edhe imazhin e turizmit ne kete zone me vlera te cmuara ekoturistike.

**5) Projekti parasheh edhe krijimin e skuadrave mjedisore të vullnetarëve mjedisorë me të rinj, dhe jo vetëm. C'fokus do të ketë puna e këtyre skuadrave dhe vullnetarëve të tjerë mjedisorë jashtë shkollës?**

Pergjigje. Skuadrat mjedisore vullnetare të cila do të perbehen kryesisht nga nxënës te shkollës së Ksamilit kanë per qellim te kryehet përmes patronazhit, shërbimet jetësore që kanë nevojë bimësia dhe përmët autoktone të ishullit në zonën e rehabilituar. Kujdestaria e tyre, do te vazhdoje edhe pas përfundimit dhe realizimit me sukses të ketij projekti madhor.

6) Porjekti përfshin edhe njohjen e publikut/sensibilizimin

për vlerat dhe statusin e ishujve nëpërmjet dy tabelave në shqip dhe anglisht që do të instalohen në bregdetin e Ksamilit përballë ishujve. C'do të përmbajnë këto tabela dhe cila është vlera/impakti I tyre në public?

- Pergjigje. Impakti dfo të jetë konkret:Ishujt e Ksamilit ne një sip. prej 6.2 ha, janë pjesa me unike, me magjepsese dhe më bukur e rivjeres se Jugut te cilet perfshihen ne territorin e Parkut Kombetar të Butrintit. Harmonia mijravjecare me detin, harmonia midis tyre e kater ishujve,bimesia autoktone e makjes mesdhetare gati e virgjier-dhe e pa depertueshme, vlerat turistike te tyre qe pa ato Parku do te ishte I varfer. Këtë originalitet, identitet dhe vecori të paperseritshme në Shqiperi do të prezantojnë dhe dy tabelat dy gjuhëshe qe do te vendosim në bregun e detit, përballë ishujve. Ta duam dhe njohim natyrën, ta besojmë atë, ta shijojmë, të bashkejetojmë në harmoni dhe te mos e lendojmë ate. Dhe ishujt në këtë drejtim jane laborator i vertetë. Do bëhet I njohur në public edhe një fakt: Për vlerat e vecanta turistike, floristike, faunistike e shkencore, per habitatet e rralla që kanë, me VKM Nr.676 date 20.12.1992, Ishujt jane shpallur Monument Natyre. Këto, publiku I gjerë dhe komuniteti që jeton atje, duhet t'i mësojë.

**8) Projekti parasheh në përfundim edhe stimulimin e ishujve me gjallesa si lepuj...Si do të mundeni ta bëni këtë për t'i shndërruar ishujt në destinacione atraktive?**

Pergjigje. Popullimi me gjallesa është nje veprim i domosdoshëm, qershia mbi torte, sic thuhet në këto raste. Përmes këtij veprimi duam të japim mesazhin për t'iu rikthyer tradites së vjeter, për t'i dashuruar dhe mbrojtur më shumë ishujt. Aty, do te vendosen korita për ushqimin dhe pirjen e ujit për kafshët dhe shpendët që do të popullojnë ishujt, duke nxitur dhe promovuar një kulture evropiane për raportet e njeriut me bimët, pemët, kafshët dhe shpendët e cdo gjallese tjeter që bashkëjeton në harmoni te plote në atë mjedis natyror.Kështu, njerezit e shek. 21, edhe ne kete pike te globit do te bëhen më miqëor me mjedisin dhe do të frymezohen prej tij.

( Intervistoi : Sofokli MEKSHI)

### NESHKRUEHET MEMORANDUMI BASHKEPUNIMI MES AGJENCISE AJMMI DHE DISA INSTITUCIONEVE

Marre nga ("Mjedisi Sot")

**SARANDE-U** nenshkrua se fundi ne Ksamil (NJA-Njesi Administrative e Bashkise Sarande) MEMORANDUMI I Bashkepunimit midis Agjencise AJMMI dhe disa institucioneve- te konsideruara si aktore dhe faktore per nje mjedis te qendrueshem ne hapësiren e ishujve joniane te Ksamilit. pjese integrale e Parkut kombetar Butrint. Memorandumi paraprin zbatimin e Projektit te AJMMI-t : "Ndërgjegjësimit mjedisor, rehabilitim i gjelbër i ishujve të Ksamilit dhe parandalimin i metejshe idemtiveve" mbështetet nga REC Shqiperi ne kuader te programit te BE- ARCHIVE (Shoqëria civile shqiptare për një Mjedis Evropian). Ne kete MEMORANDUM vleresuar si nje instrument i rendesishem institucional; nenprefektura e Sarandes perfaqesohet nga z.Illir Hysi , "AJMMI", nga z.Shkëlqim Hajno;(dr.ekzekutiv), Parku Kombetar Butrint,nga drejtori i ZAKB, z.Gjergji Mano; Njësia Administrative Ksamil (Bashkia Sarande), nga z.Florian Sali, Shkolla e bashuar KSAMIL nga z.Resmi Saliu, dhe ZA (Zyra Arsimore Sarande nga z.Astrit Llanaj.

Dokumenti vlereson si prioritet te perbashket rendesine jetike te ruajtjes se zonave te mbrojtura për nje mjedis të qëndrueshem dhe te vlerave te trashëgimise kulturore kombetare; Memorandumi e konsideron qellim te perbashket ruajtjen e interesave te ligjshme ne zonat e mbrojtura si pasuri kombetare me nje status te vecante; Duke e konsideruar situaten e demtimit të vlerave mjedisore ne zonat e mbrojtura, një emergjencë mjedisore;Memorandumi nenvizon vullnetin e përbashkët dhe nevojën e bashkepunimit për frenimin e krimeve mjedisore dhe parandalimin e dukurive të tilla në të ardhmen;....

## *Informacioni nga institucionet, rrit besueshmerine, transparencen, kulturen e komunikimit*



**Nga Panajot BOLI**

**C**do qytetar ka nevojë për një informim të saktë e korrekt. Kjo rrit besueshmerinë, transparencën, shmang konfliktet, parandalon panikun, përmirëson kulturën demokratike të komunikimit. Shoqëria jonë ka nevojë për standarte të reja në fushën e informacionit. Me keqardhje konstatojmë se në tregun e informacionit kemi një informim bruto, të pakonfirmuar. Pse themi bruto? Se ka shpesh disinformim nga qytetaret po edhe nga njerëzit e medias.

Nga se vjen ky disinformim që sjell pasojë negative? Arsyeja është se nuk i drejtohem burimit të informacionit. Ky burim gjendet te institucioni. A janë të ndërgjegjësuar të dy palët për këtë marrje-dhënie informacioni, apo secila ka cungimet e veta? Nga përvoja jonë kemi vërejtur se ka akoma institucione që kanë në dorë informacionin edhe ndrydhen, ngurtësohen, i shmangen dhënies së informacionit nga frika se u hapen telashe, preken marrëdhëniet me eprorët, etj. Pala tjetër marrëse, gjen rrugën më të shkurtër, i drejtohet burimeve jo të konfirmuara, informacion “te rrugës”. A ekziston një ligj për të drejtën e informimit? Sigurisht që ka, por thelbi është sa e njohin të dy palët. Për këtë, para pak kohësh në Sarandë Instituti Shqiptar i Medias zhvilloi një seminar trajnues për të drejtën e informimit. Çfarë ndodhi?

Shumë gazetarë aplikuan kërkesa për dhënie informacioni në disa institucioneve. Rezultati? Pjesa më e madhe nuk iu përgjigjen këtyre kërkesave. Por ka edhe shembuj pozitiv. Bashkia e Finiqit me kryetar Leonidha Kristo u treguan korrekte. Në tregun e sektorit të emergjencave civile lidhur me masat për parandalimin e zjarreve dhe dëmeve të shkaktuara në rastin konkret të zjarrit të rënë në 20.07.2016 në Cerkovicë, Shëndre, Dhivër. Brënda 8 ditëve (afati i ligjit është 10) kisha në dorë përgjigjet e detajuara me shifra e fakte konkrete dhe një tablo të qartë të punës shumë të përgjegjshme që bëhet në këtë bashki për rrezikun e zjarreve.

Konstatimi im ishte: një informacion i plotë, i besueshëm me fakte dhe jashtë informacionit të pakonfirmuar që kisha vetë unë si gazetar dhe qytetar. Në rrjetet sociale që pasqyruan episodin e 20 korrikut, për zjarrit në Cerkovicë, Shëndre, Dhivër, jepnin një disinformim të plotë, se “u dogj një shtëpi”, “dëmet janë biblike”, “erdhën disa avione nga Greqia”, etj.. Informacioni që na jep Bashkia është korrekt: asnjë njeri i lënduar, asnjë shtëpi e dëmtuar. Morën pjesë në operacion dy zjarrfikëse nga Saranda, një nga Delvina, një nga Gjirokastra dhe një nga Igumenica, kurse për avione, një ishte dhe ky nga Greqia. Konfirmimi zyrtar:

erdhën disa forca ushtarake nga Gjirokastra, 70 vullnetarë e vrojtues. Në krye të operacionit ishte vetë kryetari I Bashkisë, Leonidha Kristo. Bashkia na informoi se 930 ha kullota e pyje u dëmtuan. Gjithashtu 250 rrënje ullinj të rinj e shekullorë si dhe 500 pemë frutore, u dogjen. Sipas ekspertëve të Bashkisë, ora e rënies së zjarrit, vendi ku ra dhe informacionet që morën nga qytetarët rezultoi se zjarri ishte i qëllimshëm. Bashkia bëri të gjitha përpjekjet për t'i eliminuar këto humbje dhe t'u vinte në ndihmë fermerëve mes kontakteve me prefekturën dhe drejtoritë përkatëse të Ministrive. Në këtë kaokofoni informacionesh dhe dizinformim, vetem burimi I mesiperz zyrtar I informacionit ishte korrekt dhe transparent. Por që të percillet informimi I sakte për median (publikun), duhet që institucionet ta kenë të qartë Ligjin mbi të Drejtën e informimit. Jo vetëm ta ketë të qartë, por ta zbatojnë në atë që ne gjitha hallkat e tyre, cka do të lehtësonte percjelljen e fakteve pa dizinformim. Po kështu, edhe njerezit e medias që vjelin këto informacione do të jenë të sakte të besueshëm dhe korrekt para publikut.

## Informimi, “ura” e lëkundur me tri harqe...

Për t'u përcjellë te publiku, lajmit/informacionit, zakonisht i duhet të kalojë në një urë më tri harqe: burimi (zyrtar)-gazetari - media. Shpesh kjo “urë” lëkundet.... Megjithë hapësirat e mëdha të fjalës së lirë dhe zhvillimeve demokratike, ende, sot e gjithë ditën, ka një krizë dyshimi dhe pasaktësisht për faktet dhe informacionet që përcillen mbi të cilat ngrihen arikujt.

Në këtë hulli, pozicioni I njeriut të medias në ato të printuara, elektronike apo media sociale), shpesh shihet ne dyshim nëse faktet, lënda e parë, janë të vërteta apo fjalë në erë, “nga xhepi dhe fantazia”...

### **Këmba e parë e “urës”.**

Gazetari. Njeriu që ka marrë përsipër të informojë publikun për një lajm a raportim. Krahasuar me praktikën, adresuar edhe seminareve trajnuese të ISHM mbi informimin, rezulton se përgjithësisht vetë gazetari, nuk e njeh si duhet ligjin për të drejtën e informimit. Duke mos e njohur ligjin, shpesh pa dashje, I ngutur edhe nga afati I dorëzimit të lajmit/shkrimit; do të sjellë nga nguti paskatësinë dhe, në rastin më të keq, dizinformimin....Shpesh harrohet se zyrtari iks, është I detyruar të japë informacionin e kërkuara sipas kriterëve dhe ligjit përkatës (Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe jo në vartësi të humorit, tekave apo konjunkturave të ditës.

### **Këmba e dytë e “urës”**

Burimi zyrtar. Shpesh kur ekziston mirëkuptimi dhe vullneti I mirë për të dhënë fakte, të dhëna, nuk lind nevoja e “kërkesës me shkrim” për informacion. Por, kur situatë është jo rozë, këtu ngec bashkëpunimi dhe nis ngërçi mes dy këmbëve të “urës”. Ku, zyrtari( specialsti) heziton, ka frikë nga titullari, drejtori, shefi, etj, dhe e përcjell njeriun e medias.....I kërkon zbatimin e kërkesës sipas ligjit. Pikërisht për


këto raste ,për institucionalizimin e këtij bashkëpunimi: gazetar-institucione, iu dedikua trajnimi i fundit për të drejtën e informimit, me gazetarë të jugpërendimit dhe ISHM (Institutit Shqiptar të Medias). Secili nga njerëzit e mediave si një ushtrim praktik hartoi dy kërkesa sipas formatit zyrtar dhe i drejtoi në dy institucione të ndryshme për të marrë përgjigje rreth pyetjeve/ çështjeve që kërkonte informacion. Respektivisht në rastin a) si nje qytetar me emer konkret dhe në rastin b) si gazetar i një media. Rezultati? Institucionet morën dhjetra kërkesa tip sipas standarit. I regjistruan në protokollin zyrtar dhe gazetarët morën numrin e protokollit dhe datën.Sipas Ligjit, afati dhjetëditor ishte limiti I përgjigjeve të institucioneve për kërkesat. C'ndodhi? Në një pejsë të mirë të rasteve, institucionet dhanë përgjigje edhe para afatit që parasheh ligji. Por, në shumë raste, kjo praktike ende nuk është përmbyllur. Disa institucioneve u dukej “ e huaj”kjo praktikë ligjore. Nisnin pyetjet e zakonshme”: Perse e doni këtë? Shumë pyetje moren përgjigje : Cili është numri i zjarreve? Sip.e pyjeve të djegur nga zjarret? Shkaqet e radhëve të gjata për pensionet? Etj.,.Por kanë ngelur në sirtar përgjigjet për shumë pyetje të tjera:-Sa orë në ditë furnizohet me uje të pijshëm qytetari sarandiot? Investimi i fundit në ujësjellës, ç'ndryshime pritet të sjellë?,Pastërtia në qytet sipas vlerësimeve dhe treguesve zyrtarë; është në përmirësim apo në përkeqësim?.etj,etj.

### **Këmba e tretë e “urës”.**

Organi i medias. Gjithësesi, sa më i saktë, i verifikuar të jetë fakti i sjellë në media, aq më i saktë do të jetë lajmi që përcjell te publiku, qoftë gazetë, media elektronike apo sociale. Më e madhe besueshmëria e cila është lëkundur jo pak aktualisht. Disa media kanë kodin e tyre të etikës, që parasheh edhe

disa filtra për të mbërritur te fakti dhe lajmi i besueshëm.Por shumë syresh, u mungon një instrument i tillë I vetkontrollit. Kësisoj relativizohet besueshmëria, në klimën e luhatjeve dhe korenteve mes graviteteve politike e sociale. Njohja me ligjin dhe të drejtën për informim” si një e drejtë Kushtetuese, ka rëndësi të ndërsjelltë dhe shumëplanëshe. Për gazetarin ,mediat po edhe per qytetarin e thjeshtë. Sakaq, edhe për vetë administratën publike dhe njerëzit që shërbejnë në hierakinë e këtyre shërbimeve; nga njësitë administrative të bashkive, bashkitë me organogramat e tyre, e më sipër, deri në qeveri.

Shpesh, në kokën e qytetari dhe të gazetarit para një bariere artificiale, ngrihet pyetja: Ku të ankohet për një zyrtar apo institucion që nuk ofron informacion sipas ligjit “Për të Drejtën e Informimit”. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është pikërisht Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky institucion ka atribut ndëshkues për rastet që parasheh ligji, duke mos anashkaluar askend në piramidën e administratës publike.



Nga Shkëlqim HAJNO

➤ *Panairi i 5 -te Kombetar i Suvenireve Artistike, me Qasje Mjedisore starton ne datat 18-19-20 Gusht 2016.*

➤ *Panairi i Pare i ketij lloji, eshte zhvilluar ne veren e vitit 2012 dhe qe prej atij viti vazhdon te mbahet rregullisht cdo vit, ne muajin gusht, cka perkon me fluksin e madh te turisteve vendas e te huaj ne Sarande.*

➤ *Mbeshteses kryesor i eventit te panairove turistike me qasje mjedisore është bashkia e Sarandes.*

➤ *Ne toptal, 15 dite ekspozime te suvenireve te larmishme, mbeshtetur ne traditat e prodhimeve shqiptare te dores.*

➤ *Eventi eshte frekuentuar nga*

*pjesë me shume se 150 subjekte prodhuese, brenda e jashte kufijve shtetërore:nga Prizreni, Gjakova,etj.*

➤ *75 % e pjesëmarrësve ne panairove, jane femra. Mosha e artizaneve pjesëmarrës nga 18-80 vjec.*

➤ *U ekspozuan mbi 5000 suvenire, shumica punime dore, ne dru, filigram, qeramike, punime leshi, mermeri, tekstili, bakri e metale te tjera, deri edhe mozaiket mbi lekure kafshesh, etj.*

➤ *Panairi i suvenireve artistike” Saranda 2016 “ eshte event i Agjencise “AJMMI- Sarande me mbeshtetjen dhe ne bashkpunim me Bashkine Sarande dhe QNK.*

*“Arbenori” Tirane.*

➤ *Ne fund te ketij Panairi, per artizanet me cilesore e me shitje me te medha, nje staf i vecante vlereson me certifikata pjesëmarrësit.*

➤ *Ne te 5 -te Panairove e zhvilluara deri sot, jane shperndare 180 Certifikata Nderi.*

➤ *Stafi i Panairit te 5 Kombetar te Suvenireve Artistike “ Saranda 2016” falenderon bizneset dhe dashamiret e ketij eventit qe bene te mundur sponsorizimin modest me mjete financiare etj sic jane Vllezërit Zhupa te Supermarket “Alfa”, Vellezerit Pepkolaj (GrandHotel”) Shpetim Muho, Pandi Gramozi, Veli Hasani, Dritan Peci etj..*

- AJMMI - FOTOKRONIKE - AJMMI - FOTOKRONIKE - AJMMI - FOTOKRONIKE - AJMMI - FOTOKRONIKE - AJMMI -



vijon nga fq 3

*Pas ecjes së gjatë midis fshtrave të zones, si Gusmar dhe Rexhinë, u ndalën në stacionin e fundit të fshatit të Nivicës.*

*Pas mbërritjes në Nivicë dhe pritjes mjaft të ngrohtë dhe miqësore, ajo që do të surprizonte ishte ardhja e ambasadores së Mbretërisë së Spanjës znj. Silvia Josefin Kortez Martin, së bashku me fëmijët e saj të veshur me bluzat kuq e zi ,të cilët padyshim i kishte sjellë për të njour me këto mrekulli të zonës.*

*Në pritje të saj ishte kryetari i bashkisë, z.Tërmet Peçi i cili i shprehu mirënjohjen e tij me të thellë duke e falenderuar në emër të të gjithë banorëve Tepelenas në përgjithësi dhe Kurveleshas-ve në veçanti. “Është një nder i madh për mua të kem këtu këta studentë të mrekullëshëm dhe këtë zonjë të nderuar e cila na bëri këtë dhuratë të çmuar në këto ditë duke ju sjellë ju të vizitoni këtë vend për të cilin ka shkruar Bajroni, Pukëvili, Hahn etj...Do doja të falenderoja këtu edhe mikun tonë të përbashkët i cili e bëri të mundur këtë vizitë, z.Auron Tare i cili ka dhënë maksimumin e tij për të shpalosur e promovuar vlerat e vendit tonë në çdo cep të Shqipërisë e veçanërisht të zonës së Kurveleshit nga ku ka edhe orgjinën e familjes së tij. Është emocionues fakti që unë shoh mes këtyre studentëve veten time 25 vite më parë ku zhvilluam një ekspozitë turistike në këto përmasa sikur jeni ju sot .Unë do t’ju premtoja se herën tjetër që të vini këtu të gjeni një rrugë të asfaltuar dhe kushte më të favorshme për zhvillimin e turizmit në këtë zonë e cila ndoshta në të ardhmen do jetë një industri ekonomike për banorët dhe një vend referimi për*

*pushimet tuaja”*

*Pas fjalës përshëndetëse, çlodhjes nga rruga dhe ngrënies së drekës në pasdite, së bashku me një grup të rinjsh niviciot, mes argëtimit dhe humorit u zhvillua dhe një ndeshje miqësore futbollit, Nivicë – Spanjë e cila rezultoi me humbjen e thellë të palës tonë në rezultatin 7-1.*

*Me fjetjen në natyrë do mbyllej dhe kjo mbrëmje për t’u finalizuar të nesërmen në zbritje me vizitën në kanionet e Ujvarës Peshturës në Lekdush, Kullat e Lerës , te pagezuara nga dy te rinju te huaj, Kristof dhe Geri në Lekdush dhe plazhin me ujin e akullt të grykës honeprerë të Bënçës pranë akuaduktit-ujesjelles të Ali Pashës. Me mbërritjen në Tepelenë për të marrë rrugën e gjatë të kthimin kanë shijuar pamjen e mrekullueshme të grykëvjoses dhe majës së Golikut sikur e përshkruante dhe Lord Bajron kur vizitoi kalanë e Aliut në Tepelenë “S’do ta harroj kurrë pamjen në të hyrë në Tepelenë pasdite ndajnatë kur perëndonte dielli.*



**Ekspozite e botimeve të AJMMI-t gjatë një aktiviteti të REC, Hotel ROGNER Tiranë**

## GJIROKASTER: Integrimi i personave me aftësi të kufizuar

Aftësia për të udhëhequr efektivisht qëndron tek ndihma që i japim të tjerëve në mënyrë që ata të arrijnë sukses ose për t'u ndjerë pjesë e përfaqësimit në zhvillimin e shoqërisë. Kjo aftësi ka të bëjë me vendosjen e qëllimeve të larta por realiste. Personat me aftësi të kufizuar kohët e fundit kanë ngritur fuqimisht zërin për nevojat e tyre sa të domosdoshme dhe jetike po aq dhe prezente. Shpesh ta papërfaqësuar dhe të pa informuar janë gjendur në mes të situatave jo të këndshme, ku të drejtat e tyre janë nëpërkëmbur. Të përfaqësuar në nivel kombëtar dhe local ata janë një zë i fuqishëm për të mbrojtur dhe kërkuar çdo të drejtë legjitime që ju takon. Janë kategoria që sot jo vetëm si nivel përfaqësimi, por dhe si vendimarrje duhet të jenë pjesa e integruar e zhvillimit të shoqërisë së emancipuar.

Angazhimi i personave me aftësi të kufizuar përmirëson proceset demokratike rigjeneron ide, dhe krijon një atmosferë motivimi e cila rezulton në ngritjen e standarteve të jetesës. Secili prej këtyre individëve, i ndërgjegjshëm për rolin e tij kërkon ndryshime që bëjnë të mundur adaptimin në shoqëri. Elemente që në pamje duken kaq shumë të thjeshta për njerezit normal, e kundërta ndodh për personat me aftësi të kufizuar. Gjërat kaq shumë të thjeshta shëndërrohen në vlera të shenjta. E gjendur në situata dhe realitete kaq të ndjeshme përballë fakteve, ne jemi bërë si shoqëri më të ndjeshëm dhe më realist.

Bashkia e Gjirokastrës ndërmjet objektiva dhe angazhimeve të tjera në fushën e ndërtimit dhe zhvillimit, duke e konsideruar këtë kategori pjesë të domosdoshme e shoqërisë ka treguar kohët e fundit vëmendjen maksimale për të siguruar akses dhe lehtësi në të gjitha institucionet e qarkut dhe hapësirat publike. Me ndihmen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim (OSCE) dhe nën mbështetjen e kryetares së bashkisë znj. Zamira Rami së fundmi u paraqit dhe një platformë mbështetje për gjithë personat me aftësi të kufizuar. Kryetarja e shoqatës së personave me aftësi të kufizuar znj. Vjollca Koko, e gjendur shpesh në pozita jo favorizuese për t'i ardhur në ndihmë këtij komuniteti, duke qënë se mbart po të njëjtat probleme shëndetësore, e ardhur pikërisht nga fusha e shëndetësisë; po trajton problemet dhe ofron ide dhe bashkëpunim sa më dinjitoz, që këta persona të mos ndihen të nënverësuar.

Të ndihmohet të tjerët duhet të jetë një shtysë natyrale në një shoqëri moderne dhe civile, kjo qasje është thelbi i mirënjohjes ndaj vetes dhe ndaj individëve me probleme shëndetësore. Vetëm kohët e fundit në të gjitha akset rrugore është punuar për funksionimin e rampave që krijon mundësinë e ecjes së lejueshme jo vetëm për këmbësorët por dhe për një pjesë të madhe të cilët përdorin karrocet për lëvizje. Madje po punohet me këmbëngulje për ngritjen qëndrave të rehabilitimit, si një alternativë për të zhvilluar aftësitë e tyre. Shumë prej personave me aftësi të kufizuar, i përkasin fushave të ndryshme të arsimit çka bën të ndjeshme nevojën e përfaqësimit të tyre në vendimarrjen dhe zbatimin e ligjshmërisë në dobi të komunitetit. Demokracia përcaktohet nga disa parime dhe praktika themelore që përmbushin një shoqëri. Një ndër parimet kryesore është se njerzit janë të gjithë të barabartë dhe kanë të drejta të caktuara individuale.

Një demokraci ekziston kur qytetarët janë të aftë të marrin pjesë në



**Nga Mimoza LLAVDANITI**

mënyrë aktive në jetën e shoqërisë së tyre duke ushtruar të drejtat e tyre individuale, si lirine e fjalës dhe mendimit. Kohezionin shoqërisë mund t'ja sigurojnë vetëm nëpërmjet pjesmarrjes në të drejta dhe vendime. Raporti i individit me shtetin, idealisht mund të jetë i tillë, që të prodhojë qytetari nga njëra anë, dhe legjitimitet nga ana tjetër. Por nëse zëri i tyre nuk dëgjohet dhe nese nuk zbatohet ligji, problemet do të jenë shumëfish dhe më të mëdha. Nisur nga këto kërkesa ndër vite, shoqata e personave me aftësi të kufizuar, në Bashkinë e Gjirokastrës ka sot një mbështetje dhe partnere të fuqishme në të drejtat e tyre. Klima e pushtetit vendor ndaj kësaj kategorie vendos ura bashkëpunimi për më shumë marrëdhënie në të drejtat e tyre legjitime. T'ju ndodhesh pranë evidenton se emancipimi i shoqërisë dhe ligjshmërisë janë domosdoshmërisht ekuacion devotshmërie. Kesisoj, në tipologjinë institucionale duhet të mirëmenaxhohen burimet njerëzore të cilat ofrojnë cilësi shërbimi. Zëri i së drejtës institucionale është padyshim ajo që prët sot kjo kategori qytetare. Tashmë sfida dhe e drejta për mbështetje, janë padyshim pika kyçe, që këta persona presin në vazhdimësi për t'u ndjere sa me mire në jetën shoqërore.

## GJIROKASTËR: Arjan Shehu, 50 vite me isopolifoninë labe në buzë



Artisti popullor i këngës isopolifonike labe, Arjan Shehu për 50 vite rresht ka sjellë koloritin dhe ngjyrat e pasura të këngëve tradicionale gjirokastrite në skenat e folkut brenda dhe jashtë vendit. Zëri i tij si marrës i isopolifonike do ta shndërronte mërmërimën e polifonisë labe në një ujëvarë ndjenjash dhe emocionesh. Ai do të këndonte me të njëjtën drithërimë, duke pasur si sfond ison burrërore, këngët e dashurisë dhe kurbetit, ato të dasmës dhe lirike. Polifonia e Arjan Shehut do të zbriste herë qetësisht e herë e zhurmshme në skenën e Festivaleve Folklorike. Dëshimtarë të talentit të tij nuk do të ishte vetëm Kalaja e gurtë, por edhe skenat e Janinës, Athinës, Parisit, Sardenjës, Marsejës; ku ai, veshur me fustanellën labe së bashku me grupin do të përfaqësonte Shqipërinë në mjaft takime folklorike të rangut ndërkombëtar. “Dëshira për të këndur këngen labe, thote Arjani, ka ardhur natyrshëm. Qysh në moshë të vogël përpara sofave të por tave karakteristike

gjirokastrike, bashkë me shokët e mi kishim dëshirë që ato që nuk shprehnim dot me fjalë, t'i derdhnim në ison e polifonisë labe “. Me kalimin e viteve kënga labe u kthye në pjesë të jetës së tij.

Në vitin 1980 së bashku me 6 shoke të tjerë ai do të bëhej pjesë e grupit “Të të rinjve të Gjirokastrës” aq i njohur për artëdashësit e polifonisë. Në vitin 1983 do të ngjitej për herë të parë në skenën e Festivalit Folklorik. Me kalimin e viteve dhe pjesëmarrjen e në dhjetra organizime të folkut, do të ndjente se isoja labe është një mesazh për të tjerët, për ndjenjat, emocionet, dhimbjet e shpirtit. “Gjithmonë spektatori e ka dashur këngën popullore pasi ajo ka qenë pjesë e natyrshme e ceremonive familjare, dasmave, gëzimeve apo brengave. Por polifonia labe, -thotë ai, ka bërë për vete jo vetëm shqiptarët por edhe të huajt”. I pashlyer i ka ngelur një koncert në Athinë në tetor 2000 me pjesëmarrjen e grupeve polifonike ballkanike. “Pasi grupi shqiptar përfundoi së kenduari, thote Arjani, interpretimi i tij u shoqërua me



Nga Blerim KORE

duartrokite nga spektatorët grekë. Por unë u befasova kur në skenë u ngjit një grup studentësh të Universitetit të Athinës, të cilët me një mjeshtëri befasuese sollën në gjuhën shqipe këngën popullore “Laj fustanin e tim zot”. Të këndosh këngën labe, për Arjanin, nuk është aq e thjeshtë. “Marrësi krahas zërit kumbues, duhet të ketë një shpirt artisti. “Dëgjuesi, - thotë ai,- duhet të ndjejë në uljen ngritjet e zërit, atë drithërimë plot jetë të shpirtit të vet. Ai ka hedhur në treg tetë albume me këngë labe për të cilat ka marrë vlerësime të shumta.”Unë mor unë, jam bir’ i juaj / kur këndoq e qesh, e vuaj”, janë vargjet e një kënge të Arjanit për të cilat ai mendon se janë edhe vargje sintezë të karrierës së tij 50 vjeçare si këngëtar i polifonisë labe të shoqëruara me interpretime të shumta në skenë ku nuk kanë mungur përfaqimet, lotët, emocionet...

### ABONOHU TEK REVISTA “URAT E MJEDISIT”

Redaksia e revistes “URAT E MJEDISIT” vazhdon të pranojë kërkesat e reja për abonim vjetor ose 6 mujor për vitin 2016. Redaksia merr persiper ta dergojë revisten deri tek porositeshi me shpenzimet e veta dhe brenda një afati dy ditësh nga botimi. Kuota për abonim vjetor është 2500 lekë. Për t’ju ardhur në ndihmë subjekteve të ndryshme, stafi botues pranon edhe abonime 6 mujore me vlerë 1500 lek. Agjencia “AJMMI” si botuese e kesaj reviste, pranon materiale si: artikuj problemor, fotografi dhe problematika mjedisore, sociale dhe me gjere.

AGJENCIA AJMMI

## Udhëve te femijerise me grekun Andonis Peskos

Rikthim pas 40 vjetesh ne Nivice.



**Nga Sofokli MEKSHI**

*-(Vijon nga numeri i kaluar )*

Me hapjen e kufijve ne vitin 90, kisha shkuar disa here ne Greqi dhe I kisha ftuar vllenzrit Pesko, per nje vizite ne fshatin tone te perbashket, sic lu pelqen ta quajne ata Nivicen. Dhe Andoni erdhi. Dhe jo vetem nje here. Dhe jo vetem ai. Te tre vllenzrit dhe motra e tyre vijne gati cdo dy vjet ne fshat. Por hera pare qe u takova me Andonin, ndodhi ne vitin 2000. Ai jeton e punon ne Australi qysh nga vitet 70, por e ka fiksime te vije ne Nivice, Bashkfshatri im taksixhi Lefter Thomai me kishte ruajtur nje surprize. Me gjeti tek sheshi para Bashkise dhe me thatha” Do te takosh nje njeri te rralle. Ai ka kerkuar shume here te te takoj por ti nuk je ndodhur ketu kur ka ardhur ai.” Une e shikoja me habi Lefterin dhe kurre nuk me shkonte mendja te Andoni nga qe ai ishte shume- shume large. Shoferi kishte lene takim para sheshit te Bashkise dhe e priste nga casti ne cast.” Ja, perpara e ke, do ta njihni njeri tjetrin apo jo” me tha Lefteri. Nje burra I gjate dhe biond, ashtu sikurse kishte qene qe ne adoleshencen e hershme, po ecte serbes drejt shoferit, por une I preva rrugen duke ifolur ne emer. –

Hajde more Sofo, sa te kam kerkuar keto vjet, dhe u perqafuam si dy vllenz. Pyetje per te shkuaren, per jeten ne Australi, per prinderit e tij te ndjere etj nuk linin kohe per pergjigje. Shumevite kishin kaluar, 40 eca, shume te tjere dote klotne, por ajo miqesi e vllazeri nuk dote ftohet, ato perjtime nuk dote shuhet kurre nga kujtesa jone deri ne te gjalle. Edhe keto rradhe kujtimsh diku dote botohen e do te lexohen me interes nga dikush si refim I dickajete larget qe reflekton dashuri midis popujve te ted y shtetev te ndryshme, fqinjve me njei tjetrin.

Periodikisht Andon Pesko vjen ne Nivice e Sarande, por edhe ne Permet e Tirane e Durres, cdo dy vjet, Se bashku ishte hera e pare qe shkonim ne Nivice.. Ndaluam tek Guri I Vilezes. Ai eshtenje vend I shenjte per ne, nje bllok guri I rrumbullaket, gati 1 meter I larte e qe ndodhet aty ne hyrje te fshatit qe prej gati nje shekulli. Aty mbremjeve uleshim te gjithë bashkjemoshataret e mehalles sone, prisnim te vinin prinderittane nga fusha e t na sillnin ndonjecope buke lepuri, sic equanin nnat ton ndonje cope uke e vogel qe ato erunin per ten a shuar uine e zgjatur te diteve te gjata te vres.. Une, Andoni, Vasil Stavri, Aleko e Risto Jorgji e Harillaq Vjeri muhabetiseshin, perseisnim mesimet e dites se nsrme dhe kendonim kenge shqipe por edhe greqisht. Atje Dhimiter Greko na lexonte ne gjuhen e vet gazeten Llaiko Vima qe botohej aso kohene Gjirokaster si zeri I minoritetit Grek ne Jug te vendit.. Thuhej se Mico e lexonte disa here ne sghtëpi tekstin pastaj vinte e na e lexonte neve.. Te ulur se bashku tani pas gati 40 vjetesh. Kush ekush te tregonte bemat e femijerise, capkenlleqet e moshespor edhendonje “mekat” te pthene. Dhe j anis I pari Andoni.

– Nga do qe kam shkuar, mbaj prej 50 vjetsh nje kujtim te bukur nga ky fshat. Po ta tregoj vetem ti Sofo, Ne Nivice kam dhene e kam mare puthjen e pare te jetes sime. Une nuk I kerkoj emer por edhe Andoni nuk ma tha. Le te mbetet I secret midis tij, vajzesniviciote dhe henes qei pa ne ato ore te von te nates, buze rruges. Pastej drejtojme shikimin nga Mali I Bardhe, tutje ne Delvine, pas drejt malit Shendelli. Shqipja e pa harruar e Andonit dhe kujtimi me hollesi I asaj periudhe te veshtire te jetes si emigrant ne Nivice, me lane pa goje. ashti sikurse me kishin lene befasues aftesia e Andonit per zgjidhjen e ushtrimeve te matematikes. – Kur na lejuan te ktheheshim andej nga kishim ardhur, na shperndane ne gjithë Greqine, une shkova ne Australi ku ishte emigrant vllai im I madh Arqilea. E nderpres une duke I thene se edhe ne ashtu epesuam 30 vjet pas jush, kur u happen kufijte e Shqiperise. Ku nuk shkuan niviciotet, nga Greqia deri ne Amerike, Angli ederi ne Kanada.. Pastaj fjalen e mer perseri Andoni, kerkon te tregoj nje kujtim nga dita e kthimit ne Greqi, permes Kakavijes..- Kur kaluam kufirin babai im Ziko, ktheu koken pas memall ena porositi” ndonjehere, me siguri edhe ne Shqiperi do happen kufijte, e kur te ndodhkjo, kudo qe te jeni, kthehuni ne Nivice, ata njerez te mire emritojne ti kujtojme” Une kete amanet te bbit e ruajtja, dhe atje larg ne Australi, kur mesova per ndryshimin e sistemittuaj, mndja me shkoi ketu ne Nivice. te kthehesha njedite patjeter ketu dhe ja erdha edoime si familjeedhe shume here te tjera, deri sa te kemi frymen gjalle. Tek shtëpiaku jetoi per gati 15 vjet, kthehemi meshume emocion.

vijon në fq 13



Kerkon dika ne harkun emurit te dritares dhe e gjen” Ziko Peskos 1948- 1963” E pastron me shami prej letre ate kujtimdhe pastaj drejtohem i nper dhomat etjera, ne katua e na bacen rreth shtepise plotme ullinj dhe arra e madhe.Me pas njgitemi tek shtpia ime, atje na prët vllai Llambi, motrat Lefteia, Izmini dhe Efigjenia dhekunata ime Elisaveta.Izmini flet greqisht, ate gjuhe qe mesoi ne vitet 5 me motren e Andonit, me Eftihine, kurse Andoni flet gjuhen shqipe. Mallengjehet kur i them se Vaso dhe Ollga nuk jetojne me. “ Grua e mire Ollga.burre I mire Vaso” dhe pastaj shton se edhe Ziko me

Sevastine jane larger nga kjo bote. Le ta ruajme ne kete vllazeri e dashui e tua lem edhe femijve tane, pse jo edhe nipave e mbesave. Pastaj mysfiri del ne ballkonin e shtepise dhe kerkon manin e bardhe qe atehere ishte pemeshumeemadhedhe ku darkave ndalonin te gjithë fshataret e shuanin urine me kokrrat e saj te embela. Por vllaiim Llambi e ka prere shumican e saaj, per u lene vend pemeve te tjera frutore. – Dua te them se ne grekerit e ardhur ne Nivice gjetem perkrahje dhe hengrem buke te mire tek ju. Beme edhe placke dhe kur u kthyem ne Greqi, ngarkuam dy makina me placka e bageti te imta.” Por motra ime Izmini qe e kishte provuar emigracionin ne Amfisa te Greqise, ia prët Andonit” Edhe neve ps vitit 90 na priten shume mire atjeku shkuam dhe kur u ktheva pas & vjetesh edhe ne me Vasilin ngarkuam nje makine te madhe me rroba dhe artikuj shtepiake qe si kishim pasur me pare. Ndersa ne tregojme tonat, Andoni kembengul te percaktoje se “ ju Niviciotet per ne mbani vendin e pare” keshtu duke

folir eduke folur harruam tekthenim got e rakise qe na kishte servirur kunta. Por Andoni ka edhe dy tre deshira , te cilat nuk nguron t’I thet haptazi: Me lejoni ta quaj vten Niviciote, dhe te beje nje stan me 5-6000 krere dele ne Heremec e te prodhoj djath NivicA. Femijve u kam lene amanet qe kur te vdes trupin te madjegin dhehirin ta ndajne ne tri pjese, nje qeske ta hedhin ne Egje, nje ne Kakome dhe tjetren ne detin e Australise. E c;ti thuash ketij njeriu te rralle. Du ate kujtoj ketu per te gjithë seky djal grek, edhe kur ishte jashte deri ne vitet 80, dergonte kartolina per vitin e riper fshatin ne emer te Keshillit te fshatit dhe autori I ketyre radhevei lexonta ne mbledhjet e hpura te fshatit. Dhe perseri Andoni: Si te harroje nene Ollgen qe na sillte buke te ngrohte me djth deleje, barba Vasos, I cili qe ne fillim na dha dy dhi me qumesht,peimet e Pilo Lekes te Lek Thomait. E shkepuz nga kujtimet dhe i them sekemi ende shume vende per te shkuar. Dhe janisim rrugetimittone neper fshat.

(vijon ne numerin e ardheshem)

## HOROSKOPI PYJOR

### Gjeni cilës pemë i përkisni

► **1 Janar-11 Janar (druri i bredhit)- Pema e misterit:**

**M**e shije te jashtezakonshme, plot dinjitet, pelqen gjithcka te mire, me humor, kokeforte, me tendenca egoizmi, shume ambicioz, i talentuar, dashnor i pakenaqur, me shume miq e armiq shume serioz.

► **12 Janar-24 Janar (druri I vidhit)- Pema e fisnikerve:**

**N**uk fal gabime,veshje plot shije,kerkesa me detaje,pelqen te udheheq por jo te bindet, I ndershem, partner besnik, I pelqen te vazhdoje per te tjeret, bujar e praktik,me sens humori.

► **25 Janar-3 Shkurt (druri I qiparnit)- Pema e besnikerise:**

**I**fort e muskulos,i pershtatshem I ne jete, kerkon para e dije, urren vetmine, dashnor i pasionuar, besnik, me humor.

► **4 Shkurt-8 Shkurt (druri I plepit)- Pema e pasigurise:**

**S**hume e bukur,jo shume besim ne svetvete, me kurajo, ka nevojë per vendosmeri, shoqeri te kendshme, i pelqen rremuja, natyre artistike, organizator i mire, partner serioz.

► **9 Shkurt-18 Shkurt (druri I credit)- Pema e mirebesimit:**

**B**ukuri e rralle, pershtatet, I pelqen luks,shendet te mire,pa ndrojtje,zbrazet te te tjeret,shëh poishte vetes,I vendosur deri ne padurim,me shume talent,etje per pune,ne kerkim te dashurise se vertete,I afte per vendime te shpejta.

► **19 Shkurt-28 Shkurt (druri I pishes)- Pema e vecante:**

**P**elqen shoqerine e kendshme, shume i forte, nderton jete te rehateshme, aktiv, natyral, shoke i mire, bie lehte ne dashuri, pasioni shuhet shpejt, dorezohet lehte, kunder gjithckaje, jo shume besues, praktik.

vijon në fq 14

## Na duhen krerë fetar... Shqiptarë të vërtetë

Pjesë nga libri "Noli, jeta ne Amerike"<sup>1</sup>

Noli ka shkruar: "Na duheshin dhe na duhen prifterinj, peshkop si edhe hoxhallare e myftinj, Shqiptarë te vertetë. Jo vegla politike te te huajve, por meshetare prej cdo feje qe t'ia kenë me te vertete perendise dhe te perhapin me drejtesi e me zell urdherimet e tij, qe t'i japin popullit te kuptoje qe njeriu mund te kete cilëndo fe qe ka gjetur prej stergjysherve dhe qe i pelqen, por s',mund te zgjedhë nje tjetër kombësi dhe te luftoje te tijën pa vene në balle nje vule te madhe prej tradhetori"

..... "S'do te duhej te ndryshonte asgje, por te krijohen krere fetare me ndergjegje e vetëdije kombetare, te cilet do te perhapnin ndricimin e cdo feje vecan dhe kuptimin e thelle qe perendia; kur dergoi profetet dhe te birnë, s'i dergoi qe te na venë te vritemi me njeri - tjatin, por qe te kemi dashuri ne mesin tone dhe te rrojme fatbardhë me qetesi e me liri.

Ne kete menyre edhe kreret fetare do t'i kontribuonin, ne te tashmen dhe ne te ardhmen bashkimit kombëtarë, Atdheut dhe lirisë."



Fan Stilian NOLI

<sup>1</sup>Autor i librit Avni Spahia, fq.79.

### Gjeni cilës pemë i përkisni

vijon nga fq 13

► **1 Mars -10 Mars (shelgu lotues)- Pema e melankolise :**

**E**mrkullueshme, melankolike, terheqese, me shije, s'ka pushim, kapricoz, indershem, me intimitet, vuan ne dashuri, partneri mbeshtetje per te.

► **11 Mars-20 Mars (driri I burrit)- Pema e dyshimit:**

**J**eten e kerkon tek e fshehta,urren veten, me stress, i qete, i ngadalte, sakrifikon per miqte, me shume talent, jo kembngules, me ankesa, xheloz, besnik.

► **21 Mars-31 Mars (druri I lajthise)- Pema e te jashtezakonshmes:**

**E**kendeshme, pa kerkesa te teperta, I kuptueshem, luftetar, popullor, I ndergjegjshem, dashnor kapricoz, partner tolerant, sens te perpikte gjykimi.

► **1 Prill-10 Prill (druri I verdhezes)- Pema e ndjeshmerise:**

**I**cilter, jo egoist, i pelqen jeta ne levizje, jete pa komplikacione, i varur, shije te holla, me emocione, kerkon shoke te mire, nuk fal lehte.

► **11 Prill-20 Maj (druri I panjes)- Pema e pavarise:**

**J**o i zakonshem, plot imagjinate, Joriginalitet, ambicioz, krenar, vetbesues , ne kerkim te se rese,

nervoz, me kompleksekujtese te mire, meson lehte, dashuri e komplikuar, impresionues.

► **21 Maj-30 Qershor (druri I arres)- Pema e pasionit:**

**N**uk gjen prehje, I cuditshem, plot kontraste, agresiv, me horizont te gjere reagon papritur, spontan, partner I veshtire, besnik, jo shpesh I pelqyer, jo pak I admiruar, strateg I padeshiruar, xheloz, pasionant, nuk ben kompromise.

► **1 Korrik-14 Korrik (plepi I eger) Pema e dyshimit:**

**I**zbukuruar,jo me besim ne vetvete, Ie kurajo, nevoje per shoqeri te kendshme, i vetmuar, pelqen femijerine, natyre artistike, orientohet ne cdo suate.

► **15 Korrik-24 Gusht (druri I geshtenjes)- Pema e ndershmerise:**

**B**ukuri e pazakonte,nuk te impresionon, i drejte, me interesa te medha, diplomat i lindur, i ndjeshem, me pak besim te vetja, dashuron vetem nje here.

► **25 Gusht-3 Shtator (frasheri)- Pema e ambicies:**

**T**erheqes, i gjalle, impulsive, me kerkesa, ambicioz, me talent, luan me fatin, egoist, i kujdesshem, besnik

ne dashuri, degjon zemren se sa arsyen.

► **4 Shtator-13 Tetor (druri i shkolles)- Druri i shijes se mire:**

**E**mbel. e pashme, shije per jeten edhe pamjen, jo egoist, kerkon jete te rehatshme, i disiplinuar, i dijshem, partner emocional, do dashuri ri\ omantike, beson pak, shume i ndergjegjshem, ndihmon shoqerin, njeri ku mund te mbreshtetesh.

► **14 Tetor-31 Tetor (druri i lisit)- Pema e trimerise:**

**M**e natyre te forte, i pameposhtur, Me veprim, i pavarur ne gjithcka, nuk mi pelqen te ndryshoje, kembengules, kembet ne tokemendjen te kthjellet, I punes dhe veprimit.

► **1 Nentor-15 Nentor (druri i fikut)- Pema e qendrueshmerise:**

**I**forte,deshire per tu sherbyer te tjereve, nuk i pelqejne kundesharet,pelqen familjen e tij, kafshet, me shume humor e dije, praktik.

► **16 Nentor-31 Dhjetor (druri i ahut)-Pema e krijuesit:**

**M**e gusto,pamje,organizim te mire, I pelqen aventuren, i dashuruar dhe do te dashuroj, zemergjere, me talent, optimist, i vendosur, jeton te sotmen, me imagjinatea te ardhemen.

(Përgatiti: Ing Kristo KAURI)

## Një histori didaktike e pabesueshme.

Një grua e veshur me një fustan me kuadrate dalëboje, me burrin e saj, veshur me nje kostum varfanjak, zbriten nga treni ne Boston dhe u drejtuan per ne zyren e presidentit te Universitetit te Harvardit. Ata nuk kishin lënë takim me të. Sekretarja qysh momentin e parë kuptoi që këta provincial nuk kishin as një punë ne Harvard.

-- Do donim te takonim Presidentin"- tha me zë te ulët burri.

--Do jete i zënë gjatë gjithë ditës"- u përgjigj prërë sekretarja.

--Do presim- u pergjigj gruaja.

Për orë të tera sekretarja nuk u hodhi asnjë vështrim duke shpresuar se atyre do t'u rëndej shpërfillja dhe do të iknin. Duke parë që ata nuk kishin ndërmend të iknin. edhe pse nuk donte ne asnje menyre te bezdiste presidentin, vendosi t'a shqetesojë, ate.

--Ndoshta po i pranuat nje minute, mbase do ikin- i tha atij.

Ai psheretiu me zemerim dhe pohoi me nje levizje koke. Dikush kaq i rendesishem sa ai, sigurisht qe nuk kishte kohe te pranonte njerez te veshur me fustane daleboje dhe me kostume te vjetëruara. Presidenti ju kthye ciftit me nje ton të ashpër dhe arrogant.

Gruaja i tha :”Kishim nje djalë që studionte në Universitetin tuaj për nje vit. E donte shumë dhe ishte i lumtur shumë ketu. Por, për fat të keq një vit me pare, vdiq papritur. Burri im dhe unë kemi dëshirë të ndertonim një monument për të në territorin e Universitetit “.

Presidenti nuk u mallengjye aspak. Përkundrazi u inatos.

”Zonjë,- u pergjigj me cinizëm-“nuk mund te vendosim statuja per cdo njeri qe studjoi ne Harvard dhe vdiq. Nëse do bëjme një gjë të tille, atëhere ky vend do duket si një varrezë.”

”Jo”- u përgjigj shpejt gruaja, “Nuk duam te vendosim statujen e tij. Kemi menduar të dhurojmë një ndërtesë në Harvard”.

Presidenti ktheu syte, u hodhi një vështrim mbi fustain dalëboje dhe kostumin e vjeter dhe bërtiti:. –

-Një ndërtesë!....

-A e dini sa kushton një ndërtesë? Kemi me shume se shtatë milion e gjysëm dollarë në ndërtesa, këtu në Harvard.”

Për një moment, gruaja ndenji e heshtur. Presidenti qeshi me ironi. Ndoshta erdhi momenti të shpëtoj prej tyre.

Gruaja u drejtua nga burri i saj dhe i tha qetësisht: “ Vetëm kaq, nevojiten për të ndërtuar një universitet? Pse nuk ndërtojmë një tjetër, atehere?”

Bashkëshorti pohoi me kokë. Fytyra e presidentit u zverdh dhe u pushtua nga konfuzioni. Zoti dhe zonja Leland Stanford u ngritën dhe dolën jashtë zyes.

Udhëtuan deri në Palo Alto në Kaliforni ku themeluan Universitetin që mban emrin Stanford Univerisity, ne kujtim të djalit të tyre të cilin Harvardi e kishte harruar. Kurrë nuk duhet të gjykojmë të tjerët nga rrobat që kane veshur.... As kur dikush imponohet më lëvozhgën e veshjes dhe popullit thotë:”Ha binish, bisht!”:.....



Perktheu: Vasilika IFANDI



AGJENCIA JONIANE  
MJEDISIT, MEDIAS  
INFORMACIONIT



BASHKIA SARANDE

# "Saranda 2016"

Panairi V Kombëtar i Suvenireve Turistike me Qasje Mjedisore



**Datë 18 - 19 - 20**  
**Gusht 2016**  
**Ora 18.00**

**Adresa: Shëtitorja "Naim Frashëri"**  
**(pranë lokalit "Harqet")**